

KARTA E QYTETEVE EVROPIANE PER ZHVILLIMIN E QENDRUESHEM

(KARTA E AALBORGUT)

(sic eshte miratuar nga pjesemarresit e Konferences Evropiane per Qytetet e Qendrueshem e mbajtur ne Aalborg, Danimarke, me 27 Maj 1994)

Pjesa I: Deklarata e Perbashket: Qytetet Evropiane drejt Qendrueshmerise.
Pjesa II: Fushata Evropiane per Qytetet te Qendrueshme.
Pjesa III: Perfshirja ne Proceset Lokale te Axhendes 21: Planet Lokale te Veprimit drejt Qendrueshmerise

Shenim shpjegues

Karta e Aalborgut eshte miratuar nga pjesemarresit e Konferences Evropiane per Qytetet e Qendrueshme, te mbajtur ne Aalborg, Danimarke nga 24 deri ne 27 Maj 1994 nen sponsorizimin e perbashket te Komisionit Evropian dhe te Bashkise se Aalborgut dhe i organizuar nga Keshilli Nderkombetar per Inisiativat Lokale te Mjedisit (ICLEI). Pergjegjesia per Projekt-Karten u mor persiper nga ICLEI ne bashkepunim me Ministrine e Zhvillimit Urban dhe te Transportit te Shtetit Federal te Northrhine-Westphalia, Gjermani. Karta pasqyron ide dhe formulime te shume kontribuesve.

Karta e Aalborgut u nenshkrua fillimisht nga 80 autoritete lokale evropiane dhe nga 253 perfaqesues te organizatave nderkombetare, qeveri kombetare, institucione shkencore, konsulente dhe individe. Duke nenshkruar kete Karte, qytetet/bashkite evropiane, komunat marrin persiper qe te hyjne ne proceset lokale te Axhendes 21 dhe te perpunojme plane veprimi afatgjata drejt qendrueshmerise, dhe filluan fushaten e Qyteteve te Qendrueshme Evropiane.

Projekt-Karta u diskutua nga me shume se 600 pjesemarres ne 36 seminare te Konferences te Aalborgut. Shume nga komentet dhe sugjerimet e tyre u perfshine ne tekstin final, por Grupi Botues i Kartes ishte i mendimet se shume propozime baze dhe themelore mbi amendementet meritonin nje konsiderim dhe diskutim me intensiv dhe nuk mund te konsideroheshin thjesht si nje problem redaktues. Per kete arsye u propozua qe shqyrtimi i amendamenteve te sugjeruara te ishte detyra e Grupit te Koordinimit te Fushates, dhe Karta e ri-perpunuar do t'i paraqitet pjesemarresve te Konferences se Dyte Evropiane per Qytetet e Qendrueshme qe do te mbahet ne Lisbon, Portugali me shtator te 1996.

THE EUROPEAN SUSTAINABLE CITIES & TOWNS CAMPAIGN

Rue de Trèves/Trierstraat 49-51, Box 3; B - 1040 Brussels

Tel: + 32 2 230 53 51; Fax: + 32 2 230 88 50

e-mail: campaign.office@skynet.be; Internet: <http://www.sustainable-cities.org>

KARTA E QYTETEVE EVROPIANE PER ZHVILLIMIN E QENDRUESHEM (KARTA E AALBORGUT)



(sic eshte miratuar nga pjesemarresit e Konferences Evropiane per Qytetet e Qendrueshem e mbajtur ne Aalborg, Danimärke, me 27 Maj 1994)

Pjesa I: Deklarata e Perbashket: Qytetet Evropiane drejt Qendrueshmerise.
Pjesa II: Fushata Evropiane per Qytetet te Qendrueshme.
Pjesa III: Perfshirja ne Proceset Lokale te Axhendes 21: Planet Lokale te Veprimit drejt Qendrueshmerise

Pjesa I Deklarata e Perbashket: Qytetet Evropiane drejt Qendrueshmerise

Roli i Qyteteve Evropiane

Ne, qytetet evropiane, nenshkruesit e kesaj karte, deklarojme se gjate historise, qytetet tona kane ekzistuar dhe sfiduar perandorite, shtetet kombetare, dhe regjimet dhe kane mbijetuar si qendra te jetes shoqerore, bartese te ekonomive, dhe roje te kultures, trashegimive dhe te traditave. Se bashku me familjet dhe fqinjët, qytetet kane qene elementet themelor te shteteve dhe shoqerive tona. Qytetet kane qene qendrat e industrise, artizanatit, tregetise, ekonomise dhe qeverisjes.

Ne e kuptojme se stili i tanishem i jetes urbane, ne vecanti modelet tona te ndarjes se punes dhe funksioneve, te perdorimit te tokes, te transportit, prodhimit industrial, bujqesise, konsumit dhe te aktiviteve clodhese, dhe rrjedhimisht standarti i jeteses na ben ne shume te pergjegjshem per shume probleme mjedisore qe njerezimi po perballon sot. Kjo eshte shume e rendesishme nderkohe qe 80% e popullsise evropiane jeton ne zonat urbane.

Eshte e qarte se nivelet aktuale te konsumit te burimeve ne vendet e industrializuara nuk mund te arrihen nga te gjithë njerezit e sotem, dhe akoma me pak nga gjeneratat e ardhshme pa shkateruar kapitalin natyror.

Ne jemi te bindur se jeta njerezore e qendrueshme ne kete glob nuk mund te arrihet pa komunitete lokale te qendrueshme. Pushteti lokal eshte prane vendeve ku jane shfaqur probleme ambientale dhe akoma me prane qytetareve dhe e ndan pergjegjesine me qeverite e te gjithë niveleve per mireqenien e njerezimit dhe te natyres. Per kete arsye, qytet jane protagonistet kryesore ne procesin e ndryshimit te stilit te jetes, prodhimit, konsumit dhe modeleve hapesinore.

I.2 Nocioni dhe Parimet e Qendrueshmerise

Ne, qytetet, e kuptojme se ideja e zhvillimit te qendrueshmerise na ndihmon ne per te bazuar standartin tone te jeteses ne kapacitetin bartes te natyres. Ne kerkojme te arrijme drejtesi shoqerore, ekonomi te qendrueshme dhe qendrueshmeri ambientale. Drejtesia shoqerore

THE EUROPEAN SUSTAINABLE CITIES & TOWNS CAMPAIGN
Rue de Treves/Tilferstraat 49-51, Box 3, B-1040 Brussels
Tel: + 32 2 230 53 51; Fax: + 32 2 230 88 50
e-mail: campaign.office@skynet.be; Internet: <http://www.sustainable-cities.org>

domosdoshmerisht duhet te bazohet ne paanshmerine dhe qendrueshmerine ekonomike, gje qe kerkon qendrueshmeri ambientale.

Qendrueshmeria ambientale nenkupton mirembajtjen e kapitalit natyror. Ajo kerkon nga ne qe niveli i konsumit te materialeve te rigjenerueshme, burimeve ujore dhe energjitike te mos kaloje nivelin e zevendesimit te ketyre nga sistemi natyror, dhe qe niveli i konsumit te materialeve te pa-rigjenerueshme te mos kaloje nivelin me te cilin zevendesohen burimet e rigjenerueshme. jane zevendesuar. Qendrueshmeria ambientale nenkupton gjithashtu se niveli i ndotesve te mos e kaloje kapacitetin e ajrit , te ujit , dhe te tokes per t'i absorbuar dhe per t'i perpunuar ato.

Per me teper, qendrueshmeria ambientale kerkon ruajtjen e biodiversitetit; shendetit te njeriut; si dhe cilesite e ajrit, ujit, tokes sipas standarteve te mjaftueshme per te mbeshtetur jeten e njeriut dhe mireqenien e tij, si dhe kafshet dhe jeten bimore, per gjithmone.

I.3 Strategjite lokale drejt qendrueshmerise.

Ne jemi te bindur se qyteti eshte njesia me e madhe ne gjendje per te trajtuar fillimisht c'ekuilibret arkitektonike urbane, sociale, politike, ekonomike, dhe te burimeve natyrore qe po demtojne boten tone moderne dhe shkalla me e ulet ku problemet mund te zgjidhen ne menyren me te integruar, te shenje dhe te qendrueshme. Meqenese cdo qytet ndryshon nga tjetri, ne duhet te gjejme menytrat tona individuale drejt qendrueshmerise. Ne duhet te integrojme parimet e qendrueshmerise ne te gjitha politikat tona dhe t'i perdorim anet me te forta te qyteteve tona baze te strategjive lokale te pershtatshme.

I.4 Qendrueshmeria si nje proces krijues, lokal dhe ekuilibruer

Ne, qytetet, pranojme se qendrueshmeria nuk eshte as nje vizion dhe as nje gjendje e pandryshueshme, por nje proces krijues, lokal dhe ne kerkim te ekuilibrit qe shtrihet ne te gjitha fushat e marrjes te vendimeve lokale. Ajo siguron informacion te vazhdueshem ne administrimin e qytetit mbi te cilin aktivitet jane duke e drejtuar ekosistemin urban drejt ekuilibrit ose c'ekuilibrit. Duke e ndertuar administrimin e nje qyteti ne baze te informacionit te mbledhur gjate nje procesi te tille, mendohet qe qyteti te funksionojte si nje teresi organike dhe te shfaqen efektet e te gjithave aktiviteve te rendesishme. Nepermjet nje procesi administrimi te ngritur mbi bazen e qendrueshmerise, mund te merren vendime qe perfaqesojne jo vetem interesat e te interesuarve, por dhe te brezave te ardhshem.

I.5 Zgjidhja e problemeve duke negociuar nga jashte

Ne, qytet, e pranojme se nje qytet nuk mund t'i lejoje vetes qe t'i exportoje problemet ne nje mjedis tjetet ose ne te ardhmen. Per kete arsye, cdo problem ose c'ekuiliber ne qytet ose duhet te cohet drejt ekilibrit ne nivelin e tyre ose duhen absorbuar nga entitete me te medha ne nje shkalle rajonale ose kombetare. Ky eshte principi i zgjidhjes se problemeve duke negociuar nga jashte. Zbatimi i ketij parimi do t'i jape cdo qyteti liri te madhe per te percaktuar natyren e aktivitetit te tij.

I.6 Ekonomia urbane drejt qendrueshmerise

Ne, qytetet, e kuptojme se faktor kufizues per zhvillimin ekonomik te qyteteve tona eshte kapitali natyror, atmosfera, toka, uji dhe pyjet. Ne, per kete arsye, duhet te investojme ne kete kapital. Sipas radhes se prioritetit, kjo kerkon:

1. investime ne konservimin e kapitalit natyror te mbetur, si ujrat nentokesore, toka, habitatet e specieve te rralla;
2. inkurajimi i rritjes se kapitalit natyror duke reduktuar shkallen tone te shfrytezimit momental, sic eshte energjia e pa-rigjenerueshme;
3. investimet per te cliruar tensionin mbi kapitalin natyror duke zgjeruar kapitalin natyror te kultivuar, sic jane parqet clodhese brenda qyteteve per te cliruar tensionin nga pyjet natyror dhe;
4. rritja e efikasitetit te perdorimit final, sic jane ndertesat e energjise me eficence, trasportet urbane shoqerore ambientale.

I.7 Barazia sociale dhe qendrueshmeria urbane.

Ne, qytetet, jemi te ndergjegjshem se te varferit preken me rende nga problemet ambientale (si zhurna dhe ndotja e ajrit nga trafiku, mungesa e kenaqesive, strehimi jo i shendetshem, mungesa e hapësirave te hapuar) dhe dhe se ata nuk jane ne gjendje t'i zgjidhin ato. Shperndarja e pabarabarte e te mirave shkakton sjellje jo te qendrueshme dhe veshtireson ndryshimin e tyre. Ne synojme qe t'i intergrojme nevojat shoqerore themelore te njerezve sic jane sherbimi shendetesor, punesimi dhe programet e strehimit me mbrojtjen e mjedisit. Ne deshirojme te mesojme nga pervojat fillestare te stilit te jetes te qendrueshme, ne menyre qe te punojme drejt permiresimit te cilesive stilit te jetes se njerezve ne vend qe te maksimizojme konsumi.

Ne do te perpiqemi te krijojme vende pune te cilat do te kontribuojne ne qendrueshmerine e komunitetit dhe si rrjedhim do te pakesojme papunesine. Kur te perpiqemi te promovojme ose te krijojme vende pune ne do te vleresojme ndikimet e cdo mundesie biznesi ne lidhje me qendrueshmerine me qellim qe te inkurajojme krijimin e vendeve afat-gjate pune dhe produkte jetegjate ne perputje me parimet e qendrueshmerise.

I.8 Menytrat e qendrueshme te perdorimit te tokes

Ne, qytet, pranojme, rendesine e perdorimit efektiv te tokes dhe te perpunimit e politikave planifikuese nga autoritetet lokale, te cilat permbajne vleresimin strategjik ambiental te te gjithë planeve. Ne duhet te perfitojme nga qellimi per te siguruar transporti publik dhe energji me oferta densiteti te larte, nderkohe ruajme shkallen e zhvillimit te shoqerise. Ne zbatimin e programeve te rinovimit urban ne zonat e brendshme urbane dhe ne planifikimin e lagjeve te reja, ne kerkojme nje perzierje funksionesh ne menyre qe te reduktojme nevojën per levizshmeri. Nacionet e ndervaresises rajonale te barabarte duhet te na krijojne mundesi per te balancuar flukset midis qytetit dhe fshatit dhe te parandalohen qytetet per te shfrytezuar burimet e zonave rrethuese.

I.9 Modele te qendrueshme te levizshmerise urbane

Ne, qytetet, do te perpiqemi per te permiresuar dhe per te mbeshtetur arritjen e mireqenien sociale dhe stileve te jetes urbane me me pak transport. Ne e dime se eshte me se e nevojshme per nje qytet te qendrueshem qe te reduktoje levizshmerine e sforcuar dhe te ndaloje promovimin dhe mbeshtetjen e perdorimeve te panevojshme te mjeteve te motorizuara. Ne do t'i japim prioritet mjeteve te transportit ekologjik (ne vecanti ecjes ne kembe, levizjes me biciklete, transportit publik) dhe do ta bejme kombinimin e ketyre mjeteve qendren perpjekjeve tona te planifikuara. Mjetet individuale te motorizuara te transportit publik duhet te kene funksionin ndihmes per te te lehtesuar perdorimin e sherbimeve lokale dhe mirembajtjen e aktivitetit ekonomik te qytetit.

I.10 Pergjegjesia per klimen globale

Ne, qytet, e kuptojme se rreziqet me te rendesishme te paraqitura nga nxehtesia globale kundrejt mjediseve natyrore dhe artificiale dhe kundrejt gjenerates se njerezve te ardhshme kerkojne nje veprim te fuqishem per te stabilizuar dhe pastaj per te reduktuar sgkarkimin e gazeve me efekt serre ne atmosfere sa me shpejt te jete e mundur. Eshte po kaq e rendesishme mbrojtja e burimeve globale te biomases, sac eshte dhe mbrojtja e pyjeve dhe fitoplanktoneve, te cilet luajne nje rol esencial ne ciklin e karbonit te tokes. Pakesimi i ndotjeve nga lendet djegese fosile do te kerkoje politika dhe inisiativa te bazuara ne nje njohje te thelle te alternativave dhe te mjedisit urban si nje sitem energjie. Te vetmet alternativa te qendrueshme jane burimet energjitike te rigjenerueshme.

I.11 Parandalimi i toksifikimit te ekosistemit

Ne, qytetet, jemi te ndergjegjshem se gjithmone e me shume po clirohen ne ajer, toke, uje dhe ushqime substanca toksike dhe te demshme dhe si rrjedhim po behen nje rrezik ne rritje per shendetin e popullsisë dhe ekosistemeve. Ne do te bejme cdo perpjekje per t'u siguruar se ndotjet e metejshe me te ndalohen dhe te parandalohen qe ne burim.

I.12 Vetqeverisja lokale si nje kusht paraprak

Ne, qytetet, jemi te vetedijshem se disponojme aftesite, njohurite dhe potencialin krijues per te cuar me tej menytrat e qendrueshme te te jetuarit dhe te projektojme dhe administrojme qytetet tona drejt qendrueshmerise. Si perfaqesues te zgjedhur ne menyre demokratike nga komunitetet tona, ne jemi ne gjendje te marrim pergjegjesite per riorganizimin te qyteteve tona drejt qendrueshmerise. Shkalla ne te cilen qytetet tona jane ne gjendje qe t'i pergjigjen kesaj sfide varet nga dhenia e te drejtave per veteqeverisje lokale, ne perputhje me parimin e varesise. Eshte esenciale qe pushtetit lokal t'i lihen kompetenca te mjaftueshme dhe t'i sigurohet nje baze financiare e qendrueshme.

I.13 Qytetaret si protagoniste kryesor dhe pjesemarrja e komunitetit.

Ne, qytetet, garantojme te permbushim mandatin e dhene nga Axfenda 21, dokumenti kryesor i miratuar ne Samitin per Token ne Rio de Zhaniero, per te punuar me te gjithë sektoret e komuniteteve tona - qytetaret, bizneset, grupet e interesuara - gjate pergatitjes te planeve tona

lokale të Axhendës 21. Në e njohim thirrjen e Planit të Peste të Veprimit të Mjedisit të Bashkimit Evropian

“Drejt Qendrueshmerise “ ku përgjegjësia për zbatimin e programit të ndahet midis të gjithë sektoreve. Për këtë arsye në do ta mbështesim punën tonë në bashkëpunimin midis të gjithë protagonistëve të përfshirë në këtë proces. Në duhet të sigurojmë që të gjithë qytetarët dhe grupet e interesuara mund të marrin informacion dhe të jenë në gjendje të marrin pjesë në proceset lokale të marrjes të vendimeve. Në do të përpiqemi të gjejmë mundësi për edukimin dhe trajnimin mbi qendrueshmerinë, jo vetëm për popullsinë në përgjithësi, por edhe për përfaqësuesit e zgjedhur dhe zyrtarët në pushtetin lokal.

1.14 Instrumentet dhe mjetet për administrimin urban drejt Qendrueshmerise.

Në, qytetet, garantojmë të përdorim instrumentat dhe mjetet politike dhe teknike të vlefshme për një trajtimin e ekosistemit në përputhje me administrimin urban. Në do të shrytezojmë një game të gjere instrumentash duke përfshirë edhe ato të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave mbi mjedisin, planifikimin ambientale, instrumentat rregullues, ekonomik dhe të komunikimit sic janë direktivat, taksat dhe gjërat; dhe mekanizmat për rritjen e ndërgjegjesimit duke përfshirë pjesëmarrjen e publikut. Në do të kërkojmë të vendosim sisteme buxhetore të reja për mjedisin që lejojnë administrimin e burimeve tona natyrore në atë mënyrë ekonomike që administrojmë burimet tona artificiale “ parate “.

Në e dimë se duhet ta bazojmë hartimin e politikave tona dhe përpjekjet për kontroll, dhe në vecanti monitorimin tonë ambientale, revizionimin, vlerësimin e ndikimeve, llogaritjet, bilanci dhe sistemet e raportimit në lloje të ndryshme treguesish, duke përfshirë ato të cilësive të mjediseve urbane, flukset urbane, modelet urbane, dhe me me shumë rëndësi në treguesit e qendrueshmerise se sistemit urban.

Në, qytetet, pranojmë se një game e gjere e politikave dhe aktiviteteve që japin rezultate ekologjike pozitive janë përdorur me sukses në shumë qytete në Evropë. Megjithatë, ndërsa këto instrumente janë mjete të vlefshme për reduktimin e ritmeve dhe të presionit të paqendrueshmerise, ato në vetvete nuk e kthejnë drejtimin e paqendrueshem të shoqërisë. Për mëgjithatë, me këto baze të forta ekzistuese ekologjike, qytetet ndodhen në një pozicion të shkelqyer për të kryer hapin e parë për të integruar këto politika dhe aktivitete në procesin e qeverisjes për të administruar ekonomitë urbane lokale nënpermjet një procesi të qendrueshem të plote . Në këtë procese në na takon të përpunojmë strategjitë tona, t'i provojmë ato në praktike dhe të shkëmbejmë eksperiencat tona.

Pjesa II

Fushata Evropiane për Qytetet e Qendrueshme

Në, qytetet, nënshkruajt e kësaj Karte, do të ecim përpara drejt qendrueshmerise duke mesuar nga eksperiencat dhe shembujt e sukseshem lokal. Në do të inkurajojmë njëri-tjetrin për të vendosur plane veprimi afatgjatë lokal (Axhenda Lokale 21), duke forcuar bashkëpunimin ndër-

autoritar, dhe duke e lidhur kete proces me veprimet e Bashkimit European ne fushen e mjedisit urban.

Ne te nenshkuarit fillojme Fushaten Evropiane te Qyteteve te Qendrueshme per te inkurajuar dhe mbeshtetur qytetet ne punen e tyre drejt qendrueshmerise. Faza fillestare e kesaj fushate do te jete nje periudhe dy vjecare, mbas se ciles do te vleresohet progresi i arritur ne nje Konferencë te Dyte Evropiane per Qytetet e Qendrueshme qe do te mbahet ne 1996.

Ne ftojme cdo autoritet lokal, qofte qytet/bashki ose komune dhe cdo rrjet evropian te pushteteve lokale qe te marre pjese ne Fushate duke miratuar dhe nenshkuar kete Karte.

Ne u kerkojme shumices se rrjeteve te autoriteteve lokale ne Evrope te kryejne koordinimin e fushates. Do te ngrihet nje Komitet Koordinues me perfaqesuesit e ketyre rrjeteve. Do te merren masa pergatitore per ato autoritete lokale qe nuk jane anetare te ndonje rrjeti.

Ne parashikojme se aktivitetet kryesore te Fushates do te jene:

- lehtesimi i mbeshtetjes reciproke ndermjet qyteteve evropiane ne hartimin, perpunimin dhe zbatimin e politikave drejt qendrueshmerise
- mbledhja dhe propogandimi i informacionit me shembuj pozitiv ne shkalle lokale
- promovimi i parimeve te qendrueshmerise ne autoritetet e tjera lokale
- rritja e numrit te nenshkruesve te Kartes
- organizimi i përvitshem i “ Cmimit per Qytetin e Qendrueshem ”
- formulime te rekomandimeve mbi politikat e Bashkimit European
- sigurimi i te dhenave per Raportet mbi Qytetet e Qendrueshme te Grupit te Experteve te Mjediseve Urbane
- mbeshtetja e politikeve lokal ne zbatimin e rekomandimeve dhe legjislacionit perkates te Bashkimit European
- botimi i nje reviste per aktivitetet e Fushates.

Keto aktivitete do te kerkojne krijimin e Grupit te Koordinimit te Fushates.

Ne do te ftojme dhe organizata te tjera qe te mbeshtesin ne menyre aktive Fushaten.

Pjesa III

Perfishirja ne proceset e Axfendes lokale 21: Planet lokale te veprimit drejt qendrueshmerise

Ne, Qytetet Evropiane, nenshkruesit e kesaj Karte, garantojme me nenshkrimin e kesaj Karte dhe me pjesemarrjen ne Fushaten e Qyteteve Evropiane te Qendrueshme se do te perpiqemi te arrijme konsensus brenda Komuniteteve tona per Axfenden lokale 21 deri ne fund te vitit 1996. Kjo do te permbushe mandatin e caktuar ne Kapitullin 28 te Axfendes 21 sic eshte rene dakord ne Samitin e Rios ne Qershor 1992. Me ane te planeve tona individuale, ne do te kontribuojme ne

zbatimin e Planit të Peste të Veprimit Mjedisit të Bashkimit Europian “ Drejt Qendrueshmerise “. Axhenda lokale 21 do të perpunohet duke u bazuar në Pjesën I të këtij Kapitulli.

Në propozojmë që në procesin e përgatitjes të planit lokal të veprimit të përfshihen fazat e mëposhteme:

- njohja e sistemeve financiare dhe planifikuese si dhe njohja e planeve dhe programeve të tjera;
- identifikimi sistematik, me anë të konsultimeve publike intensive, të problemeve dhe të shkaqeve të tyre;
- priorizimi i detyrave për të trajtuar problemet e identifikuar;
- krijimi i një vizioni për një komunitet të qendrueshëm nëpërmjet një procesi pjesëmarrës duke përfshirë të gjithë sektorët e komunitetit;
- marrja në konsideratë dhe vlerësimi i opsioneve alternative strategjike;
- krijimi i një plan veprimi afatgjatë drejt qendrueshmerisë i cili përfshin qëllime të arritshme;
- programimi i zbatimit të planit duke përfshirë përgatitjen e një grafiku kohor dhe caktimi i përgjegjësive midis partnerëve
- caktimi i sistemeve dhe procedurave për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e planit
- Në do të na duhet të shqyrtojmë nëse përgatitjet e brendshme të autoriteteve tona lokale janë të përshtatshme dhe efektive për të lejuar përpunimin e proceseve të Axhendës lokale 21, duke përfshirë plan veprimet lokale afatgjatë drejt qendrueshmerisë. Mund të jetë e nevojshme që të behen përpjekje për të përmirësuar kapacitetin e organizimit, i cili do të përfshijë shqyrtimin e përgatitjeve politike, procedurave administrative, bashkëpunimin ndër-disiplinor, burimet njerezore të vëna në dispozicion dhe bashkëpunimin ndër-autoritar duke përfshirë shoqatat dhe rrjetet.

Neshkruar në Aalborg, Danimarkë, më 27 Maj 1994



**FUSHATA EVROPIANE E QYTETEVE TE
QENDRUESHME
FUSHATA EVROPIANE E AXHENDES LOKALE 21**

**FORMULAR PJESMARRJEJE
per autoritetet lokale ose rajonale**

Une, i nenshkruari, shpreh mbeshtetjen tone ne emer te autoriteteve tona lokale ose rajonale per Karten Qyteteve Evropiane drejt Qendrueshmerise, (Karta e Aalborgut) dhe angazhohemi per qellimet....

- me autoritet te plote per te nenshkruar
- me ratifikimin e perkohshem te Bashkise ose Keshillit Raonal

Emri i bashkise/rajonit
(ju lutem shenoni ne anglisht ne
se po nenshkruani ne emer te
bashkise ose rajonit)

Emri i Kryetarit te Bashkise
Zj/Z

Emri dhe titulli i
nenshkruesit

Funksioni i nenshkruesit

(Vendi)

(Data)

(Firma)

PYETESOR PER ANETARET DHE ANETARET POTENCIAL TE FUSHATES PER QYTETET E QENDRUESHME

Emri i bashkise ose rajonit _____

Emri i Kryetarit te Bashkise (Zj/Z) _____

Emri dhe titulli i personiit qe duhet kontaktuar _____

Departamenti _____

Funksioni _____

Adresa _____

Vendi _____

Nr.i telefonit _____

Nr.i faksit _____

Adresa e postes elektronike _____

Numri i banoreve _____

Gjuha qe flitet ne zonen tuaj _____

Eshte bashkia/rajoni anetare e nje rrjeti evropian per autoritetet lokale? PO
 JO

Nese po, ne cilin _____

Disa dokumenta te Fushates mbi Qytetet e Qendrueshme do te botohen vetem ne Anglisht, Frengjisht dhe Gjermanisht me qellim qe te mos rriten shpenzimet. Cilet nga gjuhete e lartepmendura do te preferoni kur materialet qe do te shperndahen nuk do te jene ne gjuhen tuaj? Ju lutem paraqisni shkallen e prioritetit me numrat 1-2-3:

- Anglisht
- Frengjisht
- Gjermanisht

Ju lutem postojeni ne:
 THE EUROPEAN SUSTAINABLE CITIES & TOWNS CAMPAIGN
 Rue de Trèves/Trierstraat 49-51, Box 3; B - 1040 Brussels
 Tel: + 32 2 230 53 51; Fax. + 32 2 230 88 50
 e-mail: campaign.office@skynet.be; Internet: <http://www.sustainable-cities.org>